



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA BERAT**  
**KRYETARI**

Nr. 2290/1 Prot.

Berat, më 06/05/2022

**V E N D I M**  
Nr. 241 datë 06/05/2022  
**PËR**

**SHTESA NË PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore", neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin Civil", I ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 108, datë 26.02.2014" Për planin vjetor të pranimit në Shërbimin Civil", vendimit nr.860 date 20.12.2021 "Për miratimin e Strukturës, Organigramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat", për vitin 2022 si edhe informacionin e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për pozicionet e lira të krijuara në shërbimin civil në kategorinë e Ekzekutive , të ulët Drejtuese si pasojë e lirimit me dorëheqje të nepunesave civil apo ngritjes në detyrë në shërbimin civil ,Kryetari i Bashkisë,

**V E N D O S I:**

1. Numri i vendeve vakante që i shtohen planit vjetor të pranimit në shërbimin civil , në administratën e Bashkisë Berat, për vitin 2022, pjesë e shërbimit civil do të jetë **2(dy)** gjithsej sipas kategorive të mëposhtëme :

a)Për kategorinë ekzekutive **1(një)**

a.1.Grupet e administrimit të përgjithshëm në kategorinë ekzekutive janë si më poshtë :

- Shkenca Ekonomike

a.2. Drejtoritë ku planifikohen vendet vakante janë :

- Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

b)Për kategorinë e Ulët Drejtuese **1(një)**pozicion

- Përgjegjës për Çështjet Sociale

b.1.Drejtoritë ku planifikohet të shtohen vendet vakante janë :

- Drejtorinë e Shërbimit Social

2.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse , në cilësinë e njësisë përgjegjëse.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

*Ervip Dushi*

